

Raportet e Progresit për Kosovën

(keq)Kuptimi dhe (keq)Interpretimi i tyre

19 Nëntor 2010

Hyrje

Raporti i Progresit është një nga dokumentet më të rëndësishme i cili vlerëson gjendjen ekonomike, politike dhe sociale në vend. Rëndësia e këtij raporti, në krahasim me shumë raporte tjera vlerësuese ndërkombëtare, qëndron edhe në atë se vlerësimi vije nga një organizëm ndërkombëtar në të cilin synon të anëtarësohet Kosova.

Pas publikimit të çdo raporti të progresit, diskutimet përqendrohen më shumë në interpretimin e fjalës "Progres" se sa në interpretimin e tij të drejtë apo marrjen e masave për përmbushjen e kërkesave që dalin nga raporti. Askush nuk konteston të gjeturat e raportit të progresit, por shprehen dallime të mëdha sa i përket kuptimësisë së progresit në Kosovë.


Me rastin e publikimit të Raportit të Progresit 2009 për Kosovën, Instituti GAP kishte publikuar një analizë me titull "Raporti i Progresit 2009 – sfidat" ku janë përshkruar sfidat, si dhe janë krahasuar raportet e progresit që nga viti 2006, në fushat si ekonomia, politika dhe standardet evropiane.

Edhe pas publikimit të Raportit të Progresit 2010 të Komisionit Evropian për Kosovë, GAP ka analizuar progresin e arritur dhe vlerësimin e përgjithshëm. Synimi i kësaj analize është qartësimi i progresit të arritur dhe sfidat që mbeten të përmbushen. Në formë të grafeve, është paraqitur progresi i arritur në bazë të frekuencave të përsëritura përgjatë raporteve të progresit 2006 – 2010.

Raporti i Progresit 2010


Raporti i Progresit 2010 konsideron se nga 99 fushat e vlerësuara vetëm në 5 prej tyre progresi ka qenë i mirë apo substancial. Ky është vlerësimi më i lartë që i jepet progresit gjatë një viti për një fushë të caktuar. Në 9 fusha nuk është shënuar fare progres. Progres apo ca (ang.: some) progres është shënuar në 43 fusha, gjersa në 43 fusha të tjera të vlerësimit është konsideruar se progresi është i vogël apo i limituar. Në krahasim me raportin e 2009, raporti 2010 ka vlerësuar më shumë pika me progres substancial apo të mirë. Pikat ku nuk ka progres kanë rënë në 9% prej 20% sa kanë qenë në 2009. Fushat të cilat është vlerësuar që ka progres apo ca progres janë rritur për 2% në 2010, kurse fushat me progres të limituar apo të vogël janë rritur në 43% nga 39% sa kanë qenë një vit më parë.

Grafikoni në vijim pasqyron në mënyrë vizuale përqindjen dhe numrin e saktë të progresit të arritur përgjatë periudhës nëntor 2009 – tetor 2010.




Raporti i Progresit 2009

Raporti i Progresit 2009 konsideron se në 20% të fushave nuk është arritur fare progres në krahasim me një vit më parë. Në 39% të rasteve progresi ka qenë i limituar apo progres i vogël, kurse në 41% të rasteve ka pasur progres apo ca progres. Sipas Raportit të Progresit të 2009, në asnjë fushë nuk ka pasur progres substancial apo progres i cili mund të klasifikohet si i mirë. Raporti i Progresit 2009 nuk dallon në shumë pika me atë të 2008, përveç që ka më pak pika ku nuk ka pasur progres, apo një rënie prej 7%.




Raporti i Progresit 2008

Raporti i Progresit 2008, i cili vlerëson progresin e arritur gjatë periudhës nëntor 2007 – tetor 2008, nuk raporton për progres substancial apo progres të mirë në asnjë fushë. Në 27% të rasteve s'ka pasur fare progres që do të thotë se në 27% të fushave progresi në Kosovë ka stagnuar përgjatë një viti të tërë. Progres jo i kënaqshëm, apo progres i vogël e i limituar është arrit në 36% të fushave, kurse progres apo ca progres është arrit në 37% të fushave. Raporti i Progresit 2008 është më i dobët se ai i vitit 2007 pothuajse në të gjitha fushat.




Raporti i Progresit 2007

Raporti i Progresit 2007 ka marrë më shumë nota negative në krahasim me Raportin e Progresit 2006, por është më i mirë se ai i vitit 2008. Në 20% të rasteve Kosova nuk ka shënuar fare progres gjatë periudhës një vjeçare vlerësuese, në 6% të fushave të vlerësuara progresi ka qenë i mirë apo substancial. Me progres apo ca progres është vlerësuar 46% e politikave publike, gjersa në 28% të rasteve progresi ka qenë i vogël apo i limituar.



Raporti i Progresit 2006

Në Raportin e Progresit 2006, 16% e fushave janë vlerësuar me progres të mirë apo substancial. Ky është vlerësimi më i mirë që është bërë në tërë raportet e progresit për vitet 2006 – 2010. Në 10% të fushave të vlerësuara nuk ka pasur fare progres. Progresi i vogël apo i limituar është shënuar në 45% të rasteve, gjersa progres apo ca progres është vlerësuar në 29% të fushave të vlerësuara.



Progresi 2006 - 2010


Grafikoni në vijim pasqyron trendin e përdorimit të vlerësimeve: 1. S'ka progres; 2. Progres i limituar apo i vogël; 3. Ka progres apo ca progres; dhe 4. Progres i mirë apo substancial.

Siç shihet nga ky grafikoni, vlerësimi për progres të mirë apo substancial është dhënë më së shumti në Raportin e Progresit 2006 dhe pastaj ka shkuar duke shënuar rënie, gjersa në Raportin e Progresit 2008 dhe atë të 2009 asnjë fushë nuk është vlerësuar me progres të mirë apo substancial. Ky vlerësim është rishfaqur sërish në Raportin e Progresit 2010.

Vlerësimi më i ulët i Komisionit Evropian është ai "s'ka progres". Ky vlerësim ka shënuar rritje në vitet 2007 dhe 2008 dhe sërish ka filluar të bie në vitet 2009 dhe 2010.

Progresi i limituar apo i vogël është vlerësim që i bëhet pjesës më të madhe të fushave dhe ky vlerësim ka shënuar rritje të vazhdueshme që nga viti 2007.

Me progres më të mirë se ai i limituar apo i vogël e që është vlerësimi me "progres apo ca progres", Raporti i Progresit i 2007 ka vlerësuar më shumë fusha, se sa raportet e tri viteve pasardhëse.



Përmbledhje e pesë Raportëve të fundit të Progresit

Tabela e më poshtme bën një krahasim për pesë raportet e progresit në secilën fushë të vlerësuar. Në fund të tabelës, në bazë të poentimit, është shënuar totali i pikëve për atë vit. Në bazë të kësaj metode të vlerësimit del se Raporti i Progresit i 2006 ka qenë raporti më pozitiv i shkruar ndonjëherë për Kosovën, kurse ai i vitit 2009 ka qenë raporti më negativ. Raporti i Progresit 2010 është më pozitiv se raportet e 2008 dhe 2009, po jo aq pozitiv sa raportet e 2006 dhe 2007.

Nuk ka përparim / shqetësimet serioze / zhvillimet shqetësuese ¹	0
Pak/e kufizuar / përparim shumë i kufizuar	1
Pak përparim	2
Përparim / përparim i madh	3

Fushat	Institucionet	06	07	08	09	10		
Politike	Demokracia dhe sundimi i ligjit	Kuvendi	3	2	2	2	2	
		Qeveria	2	2	2	2	3	
		Administrata Publike	0	2	1	1	1	
		Gjyqësori	1	1	1	0	3	
		Politikat kundër korrupsionit	1	2	2	1	2	
	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave	Mbikëqyrja e ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut	n/a	1	1	2	1	
		Të drejtat civile dhe politike	3	1	2	2	1	
		Të drejtat ekonomike dhe shoqërore	1	1	1	0	1	
		Të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore, mbrojtja e pakicave	2	1	3	1	1	
	Çështjet rregullative dhe obligimet ndërkombëtare	3	3	2	2	1		
	Ekonomike	Funksionimi i ekonomisë së tregut	Politikat e domosdoshme ekonomike	2	2	1	1	1
			Stabiliteti makroekonomik	1	1	0	0	2
			Ndërlidhja e forcave të tregut	3	3	2	1	2
Hyrja dhe dalja në treg			1	1	0	0	0	
Sistemi ligjor			2	1	1	0	0	
Zhvillimi i sektorit financiar			2	2	2	2	2	

¹ Poentimi është bërë në atë mënyrë ku me 0 pikë është vlerësuar në ato raste ku nuk ka fare progres; 1 pikë në ato rastet kur progresi është i limituar apo i vogël; 2 pikë për rastet kur ka progres apo ca progres; kurse me 3 pikë është vlerësuar fusha në të cilën ka pas progres të mirë apo substancial.

	Kapaciteti për tu përballur me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut	Ekzistenca e funksionimit të ekonomisë së tregut	0	0	0	0	0
		Kapitali njerëzor dhe fizik	1	2	1	1	1
		Struktura sektoriale dhe e ndërmarrësis	0	0	0	0	0
		Ndikimi i shtetit/qeverisë mbi konkurrencës	3	1	2	2	0
		Integrimi ekonomik dhe kriteret e konvergencës	2	n/a	3	3	1
Standardet Evropiane	Tregu i brendshëm	Lëvizja e lirë e mallrave	1	2	0	0	1
		Lëvizja e njerëzve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit	2	1	1	0	1
		Lëvizja e lirë e kapitalit	1	1	2	1	2
		Doganat	3	3	2	2	2
		Tatimet	2	1	0	2	2
		Konkurrenca	1	1	0	2	2
		Prokurimi publik	0	2	2	0	1
		Ligji mbi të drejtën e autorësisë	1	1	1	1	1
		Punësimi dhe politikat sociale	1	1	1	1	1
		Arsimi dhe hulumtimi	n/a	1	2	3	2
		Çështjet që ndërlidhen me OBT-në	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
	Politikat sektoriale	Industria dhe NVM	2	2	1	1	2
		Bujqësia dhe peshkimi	0	1	2	2	1
		Ambienti	2	2	1	2	2
		Politikat e transportit	3	2	2	2	2
		Energjia	2	2	2	1	2
		Shoqëria informatike dhe mediat	1	1	1	2	1
		Kontrolli financiar	2	2	2	2	2
		Statistikat	1	1	1	2	2
	Drejtësia, liria dhe siguria	Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi	1	1	1	2	1
		Shpëlarja e parave	1	2	1	0	1
		Narkotikët	1	1	0	2	1
		Policia	3	2	2	1	2
		Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit	1	1	1	1	1
		Mbrojtja e të dhënave personale	0	0	0	0	1
		Total	65	63	57	55	61



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:

